



REPUBLIKA E KOSOVES

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E DECANIT

MUNICIPALITY OF DECANI - OPSTINA DECANI

KONTRATA

KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

N.T.SH."GIPA"-Deçan (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

Titulli i kontratës; Furnizim me veshmbathje dhe material tjetër tekstili për shtëpinë e komunitetit

me numër Identifikues : **631-20-343-1-3-6** me nr. të bren. **631 20 003 136**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim me veshmbathje dhe material tjetër tekstili për shtëpinë e komunitetit sipas specifikimit teknik dhe ofertës financiare.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **05.03.2020** dhe përfundon me **05.03.2021**.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 3 ditë nga data e marrjes së urdhèreses.

1.4 Vend i *dërgimit të furnizimeve* do të jetë *në Shtëpinë e komunitetit në Deçan..*

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

DALESHE- CLAZNA - LUTONI		REPUBLIC AND COUNCIL OF THE REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA DECANI - TËRIT NË TËRIT - DECANI MUNICIPALITY			
Nr. faksimile	Ditë	Nr. faksimile	Ditë
Ditë	Nr. faksimile	Ditë	Nr. faksimile
Org. që dërgon	Org. që dërgon	Org. që dërgon	Org. që dërgon
Nr. faksimile	Nr. faksimile	Nr. faksimile	Nr. faksimile
BR. SHTRIGJ	BR. SHTRIGJ	BR. SHTRIGJ	BR. SHTRIGJ
No. pages	No. pages	No. pages	No. pages
2 Prokunint		6994	
02		0503 20	
DECAN DECANI			

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 **Cmimi total i kontratës do të jetë: 8.305,10 Euro ; [Tetëmijetreqindëpesë e dhjetë / Euro.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet të gjitha aspektet të plotësojnë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *furnizimeve*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë. Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve* të pa dorëzuar deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njofimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmon ton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimeshit nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore departamenti për qeshje ekonomike në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi


14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen *Shqip* në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Milot Iberhysaj	Emri:	Xhevdet Ramosaj
Pozita:	Drejtør	Pozita:	Menaxher i zyrës prokurimt
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.03.2020	Data:	05.03.2020
Vula:		Vula:	



Lista e çmimeve

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njesi	Totali €
1.	Pixhame dimërore	Palë	85	4.50	382.50
2.	Xhempera	copë	170	3.00	510.00
3.	Papuqe te mbrendshem	Palë	35	2.50	87.50
4.	Blluza per meshkuj me meng te gjata	Palë	85	2.00	170.00
5.	Te mbrendshme per mashkuj	Palë	138	1.20	165.60
6.	Te mbrendshme per femra	Palë	35	1.20	42.00
7.	Qarqafa per dushek te pambukut klef 1 (me llastik)	Palë	165	3.00	495.00
8.	Plastikë me fioka per tesha	Copë	15	25.00	375.00
9.	Mbulesa plastike per tavolina	m	55	2.50	137.50
10.	Batania	Copë	55	7.00	385.00
11.	Qorapa	Palë	400	0.50	200.00
12.	Trenerka komplet	Palë	170	7.00	1,190.00
13.	Peshkira te medhenjë	copë	60	1.90	114.00
14.	Peshkira te vegjel	copë	55	0.90	49.50
15.	Dyshek per persona me nevoja te veqanta	copë	12	85.00	1,020.00
16.	Papuqe per oborr	Palë	90	3.00	270.00
17.	Plastik fioka per oborr	copë	30	22.00	660.00
18.	Kanatiera (nenkemisha)	copë	35	1.50	52.50
19.	Kemisha (pranverore,dimrore)	copë	60	3.00	180.00

GIPA